

Në bazë të nenit 29, paragrafi 2, nenit 34, paragrafi 3 dhe nenit 40 paragrafi 1 të Ligjit për pronën shtetërore ("Fletorja zyrtare e MZ", nr. 21/09 dhe 40/11), nenit 4 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 2 dhe nenit 9 të Urdhërësës për shitjen dhe dhënien me qira të sendeve në pronësi shtetërore ("Fletorja zyrtare e MZ", nr. 40/10), nenit 4, nenit 10 paragrafi 2, nenit 28 paragrafi 1, pika 1, nenit 34, nenit 38, paragrafi 1, pika 9 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fletorja zyrtare e MZ, NR. 2/2018), NENIT 27, PARAGRAFI 1, PIKA 1, NENIT 36, PARAGRAFI 2 DHE NENIT 42, PARAGRAFI 1, PIKA 9 TË Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat e komunës", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), me pëlqimin paraprak të Qeverisë së Malit të Zi Përfundimin e dhënë numër _____ të datës ____ . ____ . 2019, Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më 31. 10. 2019, ka nxjerrë

VENDIM

për shitjen e tokës në pronësi të Komunës së Ulqinit

Neni 1

Shitet toka në pronësi të Komunës së Ulqinit dhe atë:

- ngastra kadastrale, numër 3532/1, me sipërfaqe 4638 m²;
 - ngastra kadastrale, numër 3534/2, me sipërfaqe 191 m²;
 - ngastra kadastrale, numër 3535, me sipërfaqe 733 m²;
 - ngastra kadastrale, numër 3537, me sipërfaqe 547 m²;
 - ngastra kadastrale, numër 3538/1, me sipërfaqe 1793 m²;
- të gjitha të regjistruar në fletën e patundshmërive numër 7175, KK Ulqin, Komuna e Ulqinit.

Neni 2

Çmimi fillestar i patundshmërive nga neni 1 i këtij Vendimi është 3.552.000,00 € (me shkronja: tre milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë), në pajtim me vlerësimin e vlerësuesit Andrija Zvicër.

Neni 3

Shitja e tokës nga neni 1 i këtij Vendimi do të bëhet përmes tenderimit publik (shitjes në ankand).

Neni 4

Thirrja publike për shitjen e tokës përmes tenderimit publik (shitjes në ankand) do të shpallet në së paku një gazetë ditore dhe në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, më së voni në afat prej 8 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 5

Procedurën e shitjes së tokës përmes tenderimit publik pas thirrjes publike e zbyton Komisioni për zbatimin e procedurës së shitjes (në vazhdim: Komisioni), të cilin me Aktvendim të posaçëm e formon Kryetari i Komunës së Ulqinit.

Procedura e shitjes së tokës përmes tenderimit publik (shitja në ankand) zbatohet në pajtim me Urdhëresën për shitjen dhe dhënien me qira të sendeve në pronësi shtetërore (“Fletorja zyrtare e MZ”, nr. 40/10).

Komisioni është i detyruar që të njoftojë Kuvendin e Komunës dhe Kryetarin e Komunës për rezultatin e procedurës së shitjes së tokës përmes tenderimit publik, si dhe vendimin për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm.

Neni 6

Pas përfundimit të Vendimit për zgjedhjen e ofertuesit të të volitshëm do të fillojë lidhja e kontratës për shitblerjen e patundshmërive, me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet reciproke të palëve kontraktuese.

Kontratën nga paragrafi 1 i këtij neni në emër të Komunës së Ulqinit e lidhën Kryetari i Komunës.

Neni 7

Shpenzimet në lidhje me vërtetimin e kontratës, tatimin në qarkullim, regjistrim dhe shpenzimet e tjera përballohen nga blerësi.

Neni 8

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

Numrë: 02 - _____

Ulqin, më 31. 10. 2019

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

KRYETARI,

Dr. Ilir Çapuni, d.v.